



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
SHPLLJE PER PLOTESIMIN E VENDEVE TE LIRA PER KATEGORINE E
ULET DHE TE MESME DREJTUESE

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë si dhe personave që plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje.

I. LEVIZJE PARALELE BRENDË SE NJEJTËS KATEGORI

Shpallje për lëvizjen paralele brënda së njëjtes kategori për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP.

1. Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e lëvizjes paralele brënda së njëjtës kategori, për pozicionin:

“Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Tregjeve dhe Masave Rregullatore”

Kategoria e pagës III-a

2. **Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:**
- **MISIONI :**

Te mbeshtese rregullimin e sektorit te sherbimeve te komunikimeve elektronike me analiza ekonomike, percaktime, rekomandime dhe te monitoroje gjendjen e konkuresnces dhe sjelljen e sipermarresve me FNT ne treg, në përputhje me parimet dhe legjislacionin ne fuqi.

- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:

Pergjegjes i Sektorit te Analizes se Tregjeve dhe Masave Rregullatore raporton tek drejtoi i drejtorise per ceshtje qe kane te bejne me analizat e tregjeve perkates, percaktimet e spermarresve me fuqi te ndjeshme, masat rregullatore, modelet e kostove, monitorimin dhe rregullimin e tarifave, e marrdheniet e interkoneksionit, raportet statistikore per qellime te ndryshme ne funksion te objektivave te AKEP. Te gjitha keto kane si qellim nxitjen e investimeve te qendrueshme dhe ekonomikisht efikase, gjithashtu dhe respektim e interesave te konsumatorëve.

- DETYRAT KRYESORE

1. Organizon punen e sektorit per monitorimin e zbatimit nga sipermarresit te detyrimeve ne lidhje me tarifat dhe kostot e shërbimeve, te cilat jane objekt kontrolli dhe rregullimi dhe pergatit relacionet perkatese per Drejtroin e Drejtorise dhe KD;
2. Organizon punen e sektorit per monitorimin e tarifave dhe ecurinë në kohë te tyre, per përgatitjen e analizave ekonomike përkatëse (krahasuese, vlerësuese, etj.) mbi tarifat ne Shqiperi dhe ne vende te tjera te rajonit dhe BE, efektet e ndryshimit të tyre, shpenzimet e përdoruesve për shërbimet e komunikimeve elektronike, dhe pergatit relacionet perkatese per Drejtorin e Drejtorise dhe KD.
3. Përgatit dhe paraqet ose merr pjese ne punen për miratim rregulla, metodologji dhe udhëzime për të mundësuar kontrollin e tarifave, të cilat janë objekt kontrolli.
4. Pergatit rregulla per llogaritjen e kostove dhe mbajtjen e llogarive te ndare, metodologji te perllogaritjes se kostove per operatoret qe kane detyrim per orientim te tarifave ne kosto;
5. Merr pjese ne grupet e punes apo individualisht ne kryerjen e analizave te tregjeve per shpalljen e sipermarresve me FNT dhe masat rregulluese. Ndjek procesin e publikimit te draftit te analizes duke pregatitur qendrimet ndaj komenteve te paleve te interesuara dhe pergatitjen e dokumentave final te analizave. Ne bashkepunim me drejtorine juridike kryen shqyrtimin e ankesave administrative te sipermarresve me FNT dhe pjesmarrjen ne gjyqe ndaj AKEP per objekte akuze lidhur me statusin e fuqise se ndjeshme ose ceshtjet qe lidhen me analizat e tregut;
6. Përgatit listen me te dhenat specifike te kerkuara rast pes rasti (me pyetesore) per qellime te analizave te tregjeve dhe menaxhon keto te dhena per qellime te analizes se tregut;
7. Monitoron zbatimin e masave rregulluese dhe marrevshjet e interkoneksionit ose oferte referencat;
8. Organizon punen, merr pjese ne grupe pune apo individualisht ne përgatitjen e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve, që zbatohen nga AKEP për shpalljen e operatoreve me FNT;
9. Organizon punen, merr pjese ne grupe pune apo individualisht ne percaktimin dhe identifikimin e tregjeve perkates per tu analizuar dhe per nderhyrje nga AKEP;

10. Përgatit raporte statistikore për qëllime të analizave të tregjeve, të publikimit në faqen e internetit të AKEP ose sipas kërkesës së epëroreve duke bashkëpunuar me sektorin e Statistikave dhe shërbimit universal;
11. Merr pjesë në grupe pune ose individualisht në përgatitjen, paraqitjen për miratim dhe publikimin e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve për interkoneksionin dhe aksesin, përfshirë rregullimin e tarifave të interkoneksionit;
12. Merr pjesë në monitorimin e aplikimit të metodologjive të rregullimit të tarifave dhe/ose kostove të interkonkesionit nga sipërmarrësit;
13. Te studiojë dhe të jetë i përditësuar me direktivat e BE dhe përvojën rregullatore ndërkombëtare në lidhje me analizat e tregjeve përkatëse dhe masat rregullatore, me tarifën dhe modelin e kostove, me ofertë referencat etj;
14. Te përgatitë përgjigje për pjesën e korespondencës së AKEP me sipërmarrësit dhe institucione të tjera në RSH për çështjet e sektorit të caktuar nga Drejtori i Drejtorisë.
15. Realizon bashkëpunimin me sektorin tjetër në Drejtori dhe me Drejtoritë e tjera, për realizimin e detyrave të caktuara;
16. Kontrollon punën për përgatitjen për publikimin e raporteve periodike përmbledhëse me të dhëna statistikore të mbledhura nga sektori i statistikave;
17. Ndjek veprimtarinë e operatorëve dhe identifikon tendencat dhe veprimet që cenojnë parimet e konkurrencës, kërkon dhe analizon informacionet e nevojshme, duke propozuar masat përkatëse;
18. Te përfaqësojë në varesi të degelimit sektorin, ashtu si dhe institucionin në forume, mbledhje dhe organizime të tjera që lidhen me çështjet e sektorit.

3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :

- Te zotërojë diplomën "Master Shkencor" në Shkencë ekonomike ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë në fuqi
- Eksperiencë profesionale në fushën e rregullimit ekonomik
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze shoqëruar me dëshmi përkatëse.
- Te njoh vendimet e Këshillit Drejtues, të cilat janë gjithnjë orientues në punë.
- Te ketë eksperiencë pune në grup, aftësi gjyqimi dhe hartimi të dokumentave të ndryshëm që lidhen me aktivitetin e sektorit.
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative dhe aftësi për të përpunuar tabelat me të dhëna numerike.
- Aftësi të mira organizuese, komunikimi dhe dëshirë për të punuar në grup.
- Aftësi vet-organizuese, dhe aftësi krijuese për të dhënë sugjerime dhe propozime të dobishme për ecurinë e punës.
- Aftësi vet-motivuese dhe për të punuar i pavaruar brenda afatëve kohore të ngushta në një mjedis pune intensiv, me qëllim përgatitjen e dokumenteve rregullatore.
- Certifikatë apo dëshmi për kualifikime në shkollime/kurse sipas profilit/sektorit ku punon.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë në nivelet me të larta drejtuese.
- Aftësi për të punuar me ngarkesë maksimale dhe afate të shkurtra

4. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedure, janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- d- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posacme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

5. Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi CV (mund të hartohet në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta))
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomës.
- Fotokopje të listës se notave.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e emërimit si nëpunës civil. (aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues)
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Vertetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vertetimin e gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>

6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr.Reshit Çollaku, brenda datës **22.01.2018**.
7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kushteve minimale të procedurës lëvizje paralele brënda së njejtës kategori dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datë **24.01.2018** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP.
Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.
8. **Konkurimi -Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43, në datën **05.02.2018** ora **12:30**.

9. Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punës
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejten e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 ” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligjin Nr. 46/2015 “PËR SHËRBIMET POSTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
- Ligjin nr.120/2016 “PËR ZHVILLIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË SHPEJTËSISË SË LARTË DHE SIGURIMIN E SË DREJTËS SË KALIMIT”
- Ligjin nr.16 – 2014 “PËR RATIFIKIMIN E INSTRUMENTEVE QË NDRYSHOJNË KUSHTETUTËN DHE KONVENTËN E BASHKIMIT NDËRKOMBETAR TË TELEKOMUNIKACIONEVE”
- Rregullore Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, e ndryshuar
- Rregullore Nr. 19 datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar

- Rregullore Nr.12, date 07.04.2010 “Për te dhenat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarresve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar
- Rregullore Nr. 27 datë 21.09.2012 Mbi “Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”
- Rregullore Nr. 32, datë 26.12.2013 “Rregulla dhe udhëzime për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos për sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”
- Rregullore Nr.35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”
- Rregullore Nr. 23 datë 29.06.2011 për “Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit”
- <http://www.akep.al/legjislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP)

10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Levizje Paralele (KPLP) i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pike për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- b. **60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë;

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Tregjeve dhe Masave Rregullatore”**

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **06.02.2018**.

12. **Njoftimi do të bëhet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **07.02.2018**.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Vetem në rast se në fund të procedurës së levizjes paralele rezulton se ky pozicion është vakant dhe nuk është paraqitur asnjë kandidat, pozicioni është i vleshem nëpërmjet procedurës së “Ngritjes në Detyrë”.

II. NGRITJE NE DETYRE

1. Shpallje për ngritje në detyrë për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP:

Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut III të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e Ngritjes në Detyrë :

“Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Tregjeve dhe Masave Rregullatore”

Kategoria e pagës III-a

2. **Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:**

- MISIONI :

Te mbeshtese rregullimin e sektorit te shërbimeve te komunikimeve elektronike me analiza ekonomike, percaktime, rekomandime dhe te monitoroje gjendjen e konkuresces dhe sjelljen e sipermarresve me FNT ne treg, në përputhje me parimet dhe legjislacionin ne fuqi.

- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:

Përgjegjes i Sektorit te Analizes se Tregjeve dhe Masave Rregullatore raporton tek drejtoi i drejtorise per ceshtje qe kane te bejne me analizat e tregjeve perkates, percaktimet e sipermarresve me fuqi te ndjeshme, masat rregullatore, modelet e kostove, monitorimin dhe rregullimin e tarifave, e marrdheniet e interkoneksionit, raportet statistikore per qellime te ndryshme ne funksion te objektiveve te AKEP. Te gjitha keto kane si qellim nxitjen e investimeve te qendrueshme dhe ekonomikisht efikase, gjithashtu dhe respektim e interesave te konsumatorëve.

- DETYRAT KRYESORE

1. Organizon punen e sektorit per monitorimin e zbatimit nga sipermarresit te detyrimeve ne lidhje me tarifate dhe kostot e shërbimeve, te cilat jane objekt kontrolli dhe rregullimi dhe perгатit relacionet perkatese per Drejtroin e Drejtorise dhe KD;
2. Organizon punen e sektorit per monitorimin e tarifave dhe ecurinë në kohë te tyre, per perгатitjen e analizave ekonomike perkatëse (krahasuese, vlerësuese, etj.) mbi tarifate ne Shqiperi dhe ne vende te tjera te rajonit dhe BE, efektet e ndryshimit të tyre, shpenzimet

- e përdoruesve për shërbimet e komunikimeve elektronike, dhe përgatit relacionet perkatese per Drejtorin e Drejtorise dhe KD.
3. Përgatit dhe paraqet ose merr pjese ne punen për miratim rregulla, metodologji dhe udhëzime për të mundësuar kontrollin e tarifave, të cilat janë objekt kontrolli.
 4. Përgatit rregulla per llogaritjen e kostove dhe mbajtjen e llogarive te ndare, metodologji te perllogaritjes se kostove per operatoret qe kane detyrim per orientim te tarifave ne kosto;
 5. Merr pjese ne grupet e punes apo individualisht ne kryerjen e analizave te tregjeve per shpalljen e sipermarresve me FNT dhe masat rregulluese. Ndjek procesin e publikimit te draftit te analizes duke përgatitur qendrimet ndaj komenteve te paleve te interesuara dhe përgatitjen e dokumentave final te analizave. Ne bashkepunim me drejtorine juridike kryen shqyrtimin e ankesave administrative te sipermarresve me FNT dhe pjesmarrjen ne gjyqe ndaj AKEP per objekte akuze lidhur me statusin e fuqise se ndjeshme ose ceshtjet qe lidhen me analizat e tregut;
 6. Përgatit listen me te dhenat specifike te kerkuara rast pes rasti (me pyetesore) per qellime te analizave te tregjeve dhe menaxhon keto te dhena per qellime te analizes se tregut;
 7. Monitoron zbatimin e masave rregulluese dhe marrevshjet e interkoneksionit ose oferte referencat;
 8. Organizon punen, merr pjese ne grupe pune apo individualisht ne përgatitjen e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve, që zbatohen nga AKEP për shpalljen e operatoreve me FNT;
 9. Organizon punen, merr pjese ne grupe pune apo individualisht ne percaktimin dhe identifikimin e tregjeve perkates per tu analizuar dhe per nderhyrje nga AKEP;
 10. Përgatit raporte statistikore per qellime te analizave te tregjeve, te publikimit ne faqen e internetit te AKEP ose sipas kerkeses se eproreve duke bashkepunuar me sektorin e Statistikave dhe sherbimit universal;
 11. Merr pjese ne grupe pune ose individualisht ne përgatitjen, paraqitjen për miratim dhe publikimin e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve për interkoneksionin dhe aksesin, perfshire rregullimin e tarifave te interkoneksionit;
 12. Merr pjese ne monitorimin e aplikimit te metodologjive te rregullimit te tarifave dhe/ose kostove te interkonkesionit nga sipermarresit;
 13. Te studioje dhe te jete i perditesuar me direktivat e BE dhe pervojen rregullatore nderkombetare ne lidhje me analizat e tregjeve perkates dhe masat rregullatore , me tarifat dhe model e kostove, me oferte referencat etj;
 14. Te përgatise pergjigje per pjesen e korespondences se AKEP me sipermarresit dhe institucione te tjera ne RSH per ceshtjet e sektorit te caktuara nga Drejtori i Drejtorise.
 15. Realizon bashkepunimin me sektorin tjere ne Drejtori dhe me Drejtorite e tjera, per realizimin e detyrave te caktuara ;
 16. Kontrollon punen per përgatitjen për publikimin e raporteve periodike përmbledhëse me të dhëna statistikore te mbledhura nga sektori i statistikave;
 17. Ndjek veprimtarine e operatorëve dhe identifikon tendencat dhe veprimet që cenojnë parimet e konkurrencës, kërkon dhe analizon informacionet e nevojshme, duke propozuar masat përkatëse;
 18. Te perfaqesoje ne varesi te degelimit sektorin, ashtu si dhe institucionin ne forume, mbledhje dhe organizime te tjera qe lidhen me ceshtje te sektorit.

3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :

- Te zoteroje diplome”Master Shkencor” ne Shkenca ekonomike ose te barasvlefshem me te, sipas legjislacionit te arsimit te larte ne fuqi
- Eksperience profesionale ne fushen e rregullimit ekonomik
- Njohuri shume te mira te gjuhes Angleze shoqeruar me deshmi perkatese.
- Te njoh Vendimet e Keshillit Drejtues, te cilet jane gjithnje orientues ne pune.
- Te kete eksperience pune ne grup, aftesi gjykimi dhe hartimi te dokumentave te ndryshem qe lidhen me aktivitetin e sektorit.
- Njohuri shume te mira praktike ne perdorimin e kompjuterit dhe te programeve aplikative dhe aftesi per te perpunuar tabela me te dhena numerike.
- Aftesi te mira organizuese, komunikimi dhe deshire per te punuar ne grup.
- Aftesi vet-organizuese, dhe aftesi krijuese per te dhene sugjerime dhe propozime te dobishme per ecurine e punes.
- Aftesi vet-motivuese dhe per te punuar i pavaruar brenda afateve kohore te ngushta ne nje mjedis pune intensiv, me qellim pergatitjen e dokumenteve rregullatore.
- Certifikate apo deshmi per kualifikime ne shkollime/kurse sipas profilit/sektorit ku punon.
- Aftesi shume te mira per te relatuar me shkrim dhe me goje ne nivelet me te larta drejtuese.
- Aftesi per te punuar me ngarkese maksimale dhe afate te shkurtra

4. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët, për këtë procedure, janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- d) Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
- e) Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

5. Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
[http://dap.gov.al/vende -vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta).
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.

- Fotokopje të diplomës.
 - Fotokopje të listës së notave.
 - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
 - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
 - Aktin e emërimit si nëpunës civil. (aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil të nivelit ekzekutiv)
 - Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
 - Vertetimin e gjendjes shëndetësore.
 - Vertetimin e gjendjes gjyqësore.
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
 - Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>
6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr.Reshit Çollaku, brenda datës **27.01.2018**.
7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kandidateve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e vecanta, të përcaktuara në shpalljen në konkurim do të dalin në datë **06.02.2018** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

8. Konkurimi

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43, në datën **19.02.2018** ora **11:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43 në datën **19.02.2018** ora **14:00**.

9. Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 ” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligjin Nr. 46/2015 “PËR SHËRBIMET POSTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
- Ligjin nr.120/2016 “PËR ZHVILLIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË SHPEJTËSISË SË LARTË DHE SIGURIMIN E SË DREJTËS SË KALIMIT”
- Ligjin nr.16 – 2014 “PËR RATIFIKIMIN E INSTRUMENTEVE QË NDRYSHOJNË KUSHTETUTËN DHE KONVENTËN E BASHKIMIT NDËRKOMBETAR TË TELEKOMUNIKACIONEVE”
- Rregullore Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, e ndryshuar
- Rregullore Nr. 19 datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar
- Rregullore Nr.12, date 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar
- Rregullore Nr. 27 datë 21.09.2012 Mbi “Publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”
- Rregullore Nr. 32, datë 26.12.2013 “Rregulla dhe udhëzime për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos për sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”
- Rregullore Nr.35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”
- Rregullore Nr. 23 datë 29.06.2011 për “Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit”

- <http://www.akep.al/legjislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, ne faqen zyrtare të AKEP)

10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyre në AKEP - KPND**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Tregjeve dhe Masave Rregullatore”**

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **20.02.2018** .

12. **Njoftimi do të bëhet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **21.02.2018**.